



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 8.5.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Alket Hyseni – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Konstituimi i komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.
2. Deklarimi i qëllimit të ngritjes së komisionit me vendimin nr.45, datë 07.05.2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
3. Zgjedhja e sekretarit për drejtimin e çështjeve administrative dhe teknike të komisionit hetimor.
4. Miratimi i planit paraprak të hetimit.
5. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka dhe Arlind Çaçani.

HAPET MBLEDHJA

Alket Hyseni – Mirëdita!

Me vendimin nr.45/2021 të Kuvendit “Për ngritjen e komisionin hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”” është ngritur komisioni hetimor me këtë përbërje: Alket Hyseni, kryetar, Myslim Murrizi, zëvendëskryetar, dhe anëtarët Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka dhe Arlind Çaçani. Të gjithë anëtarët e komisionit janë të pranishëm.

Anëtarët zëvendësues të këtij komisioni nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste janë Ermonela Felaj dhe Xhemal Qefalia; nga Grupi Parlamentar Demokraci dhe Drejtësi, Edmond Stojku dhe Eugen Bojaxhi.

Vendimi i Kuvendit për ngritjen e këtij komisioni hetimor është botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 5.7.2021 dhe ka hyrë në fuqi menjëherë.

Bazuar në nenin 11, pika 1 të ligjit nr.8891/2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, mbledhja e parë e komisionit thirret nga kryetari dhe zëvendëskryetari i tij jo më vonë se tri ditë nga data e marrjes së vendimit për krijimin e komisionit. Po sipas këtij ligji dhe këtij neni (pika 4) përcaktohet se kryetari deklaron qëllimin e ngritjes së komisionit, përcakton detyrat e komisionit, si dhe planin paraprak të hetimit.

Në këto kushte, duke qenë se kuorumi është i mjaftueshëm, mbledhja është e vlefshme.

Unë do të doja t’ju thosha, të nderuar kolegë, por edhe opinionit publik, që ky është një moment i veçantë për parlamentarizmin, për Republikën tonë. Është rasti i parë kur kërkohet drejtpërdrejt shkarkimi i Presidentit të Republikës nga një grup prej 49 deputetësh, të cilët, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Kuvendit, i kanë drejtuar një kërkesë Kuvendit. Vendimi i Kuvendit është bazuar pikërisht në kërkesën për ngritjen e këtij komisioni hetimor.

Nga momenti kur secili nga ne, anëtarët e këtij komisioni, jemi mandatuar nga Kuvendi, përtej bindjeve tona personale, përtej bindjeve tona politike, unë u bëj thirrje të gjithë anëtarëve që tashmë detyra jonë është detyra e një eksperti të caktuar nga Kuvendi, që, bazuar në hetimin që do të bëjë ky komision, në provat që do të administrohen, bazuar në një plan hetimi, që do ta ndërtojme së bashku, bazuar në dëshmitë apo në informacionet që mund të merren nga burime të tjera apo nga dëshmitarë, bazuar në dëshminë e Presidentit të Republikës dhe në bindjen tonë të brendshme, duhet të marrë vendime të drejta, pa paragjykuar procesin dhe që do të hyjnë në histori, vendime të cilat, në radhë të parë, duhet të kenë parimin e republikës

parlamentare, në themel të së cilës është Kuvendi dhe nga ku burojnë dhe kontrollohen në bazë të Kushtetutës të gjitha institucionet dhe pushtetet e tjera.

Në këtë këndvështrim, përtej anës sonë politike, këtu do të bazohemi vetëm në detyrimin tonë kushtetues, në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin “Për komisionet hetimore”.

Nuk dua ta zgjas. Kjo është një mbledhje konstituive. Së bashku me nënkryetarin, të cilin e kemi thirrur, ashtu sikurse e përmenda në zbatim të detyrimit, apo përcaktimit në ligjin përkatës “Për funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe duke qenë se edhe kuorumi që përmenda është në përputhje me këtë, madje janë 100% të anëtarëve, jemi në rregull për të vijuar mbledhjen.

Sipas ligjit më duhet, si kryetar, të paraqes qëllimin e ngritjes së këtij komisioni dhe detyrat e tij. Objektivi i këtij komisioni përcaktohet nga vendimi e parlamentit për ngritjen e këtij komisioni, edhe ky i iniciuar dhe i bazuar mbi kërkesën e deputetëve dhe ju bëj me dije, se sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ngritja e komisioneve është e detyrueshme sa kohë ka një kërkesë, e cila është në përputhje me parashikimet e Kushtetutës, me numrin e firmëtarëve, me kërkesat që bën në referim të neneve përkatëse dhe e paraqitur në formën dhe procedurën e caktuar. Kjo është parashikuar në Kushtetutë, është parashikuar edhe në Rregulloren e Kuvendit, ku Komisioni i Ligjeve, pasi i kaloi nga Kryetari i Kuvendit kërkesa, kreu procedurën e tij, zhvilloi mbledhjen, i bëri kërkesë Presidentit të Republikës, apo i bëri me dije të drejtën e tij për t’u dëgjuar, Presidenti i Republikës nuk u paraqit në afatin e kërkuar nga komisioni, duke e njoftuar Komisionin e Ligjeve për një pamundësi të tij për këtë afat për t’u paraqitur, por është e drejta e Presidentit. Më tej Komisioni i Ligjeve i paraqiti një raport Kuvendit dhe Kuvendi dje me miratimin e raportit vendosi ngritjen e këtij komisioni me objekt të punës së tij:

a) Hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore të prillit 2021, përbëjnë shkelje të rëndë kushtetuese.

b) Verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Republikës së Shqipërisë.

c) Verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

Ky ishte objekti i punës, pra qëllimi i veprimtarisë. Jemi të detyruar të qëndrojmë *strikt* në këtë objekt pune, i cili bazohet nga vendimi i komisionit.

Doja t’ju bëja me dije se mbledhja zhvillohet *live*, transmetohet nëpërmjet platformës së komunikimit nga Kuvendi në zbatim të detyrës dhe përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit për transparencë të plotë të veprimtarisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në zbatim të ligjit ne kemi dhe një detyrë në mbledhjen e parë, ky komision duhet të zgjedhë një sekretare, ashtu sikurse dua t’ju bëj me dije se administrata e Kuvendit, sekretari i Përgjithshëm, ka vënë në dispozicion të këtij komisioni sekretariatit teknik, i cili do ta asistojë me ndihmë këtë komision, duke pasur në përbërjen e tij edhe këshilltarë të vyer, me eksperiencë në çështjet kushtetuese.

Në cilësinë e kryetarit, do të propozoja që sekretare e komisionit të jetë kolegja e nderuar, zonja Klotilda Bushka.

A ka propozim tjetër nga anëtarët e komisionit?

E hedhim në votim.

Kush është dakord me zgjedhjen e zonjës Bushka si sekretare? Të gjitha votat pro.

Urime, sekretare!

Në kuptim të funksionit dhe të konstituimit të këtij komisioni, pas zgjedhjes së sekretares, sikurse është përcaktuar në ligj, kemi një rend dite të përcaktuar, ku në vijim, pika e katërt, është miratimi i planit paraprak të hetimit.

Secili nga ju ka një dosje pune, në të cilën ndodhet edhe plani paraprak i hetimit; po ashtu, në dosje keni vendimin e komisionit, urdhrin për thirrjen e mbledhjes dhe kërkesën e paraqitur nga deputetët. Të njëjtat dokumente i keni edhe në rrugë elektronike.

Për çfarëdo të keni nevojë, për sa i përket bazës ligjore, do të keni kopje të Kushtetutës, kopje të ligjit “Për komisionet hetimore” dhe çdo akt tjetër të nevojshëm.

Ju bëj me dije se për çdo kërkesë, mund t’i drejtoheni sekretarisë teknike, e cila do të jetë në dispozicion për çdo nevojë tuajën në funksion të përmbushjes së kësaj detyre të rëndësishme.

Spartak Braho – A mund të jap disa sugjerime?

Alket Hyseni – Po.

Spartak Braho – E para, tek aktet ligjore, përveç Kushtetutës, është e domosdoshme të kemi Kodin e Procedurës Penale, Kodin Zgjedhor, organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore, raportet e Komisionit të Venecies dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat, në disa raste kanë trajtuar marrëdhëniet me Presidentin. Zonja Bushka, ty do të bjerë për pjesë kjo punë.

E dyta, unë kam qenë pjesëtar në disa komisione hetimore dhe do të kërkoja të përcaktohet, si pikë e veçantë, fondi që duhet të vihet në dispozicion të komisionit hetimor. Pra, këtij komisioni do t'i akordohet një fond i posaçëm dhe ne duhet ta kemi përpara, sepse do të lindë nevoja të kemi ekspertë, e të tjera. Ta legalizojmë, megjithëse thuhet: “Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të Kuvendit, si dhe të ngrejë sekretariatit teknik në mbështetje të veprimtarisë së komisionit me kushte të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij”. Domethënë, të ketë parasysh fondin që vihet në dispozicion të komisionit.

Lidhur me planin paraprak të hetimit si çështje, unë do të sugjeroja: ne jemi *quasi* gjykatë ose *quasi* prokurori dhe na është dhënë në dorë për të hetuar një çështje mbi bazën e së cilës do të arrijmë në përfundime nëse ka apo nuk ka shkelje të rënda nga Presidenti i Republikës që përbën edhe thelbin dhe përfundimin e punës së këtij komisioni, pra, ngritjen e akuzës që Presidenti ka bërë apo jo shkelje. Kjo do të thotë se ne duhet të jemi shumë korrektë me medien. Për mua as prokuroria dhe as gjykata nuk duhet të flasin publikisht dhe që nga ky moment duhet të ndalohen. Ne mund të caktojmë një njeri që të flasë në emër të komisionit, kryetarin apo nënkryetarin e të tjerë, por ne nuk duhet të prononcohemi që Presidenti kështu apo Presidenti ashtu. Pra, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në këtë çështje, me qëllim që të shmangim edhe akuzat që mund të na bëhen për prononcime të pamatura.

Te plani i hetimit, i nderuar kryetar, do të na nevojitet të njohim jo vetëm deklaratimet e Presidentit, se ky është thelbi i të gjitha shkeljeve të shoqëruara këto edhe me veprime aktive, por edhe filmimet; nuk i duam vetëm në formën e shkruar, por duhet të kemi tabelën dhe t'i shikojmë publikisht të gjitha shfaqjet apo imazhet, për të cilat akuzohet Presidenti i Republikës. Kjo është më mirë për ne kur i shikojmë dhe kur i dëgjojmë vetë, por edhe për publikun. Kaq kisha unë.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Braho!

Bashkohem me këshillën tuaj, një këshillë e vyer për të gjithë anëtarët e komisionit për shkak të delikatesës që ka ky komision. Prandaj unë ndërhyra në fillim dhe thashë që, përtej bindjeve tona politike, misioni ynë tashmë është vetëm përballë Kushtetutës dhe ligjit. Ne e kemi thënë se nuk është ndonjë kënaqësi e madhe që të ngrihet ky komision dhe nuk besoj se në jetën parlamentare është kënaqësi të ketë ngjarje të tilla, por në kushtet ku jemi ne duhet ta marrim me kujdes, me gjakftohtësi dhe vërejtja juaj që ne, anëtarët e komisionit, nuk duhet të bëjmë komente të pavend, besoj se duhet të përbëjmë mënyrën e punës sonë, do të jetë rregull sjelljeje e këtij komisioni, për të cilin zoti Braho do të hartojë edhe një rregullore dhe patjetër

që këtë gjë do ta përcaktojmë në Rregullore. Nuk është se ka ndonjë ndalesë në Kushtetutë apo në ligj, por nga pikëpamja etike ajo vlen shumë.

Së dyti, për sa i takon planit të hetimit, sot paraqesim vetëm një plan paraprak, i cili nuk është përfundimtar. Në mbledhjen tjetër do të marrim sugjerimet e secilit nga anëtarët për të definuar një plan përfundimtar hetimi, në mënyrë që të krijojmë një ekspozitë të plotë, të sigurojmë prova të çdo pretendimi të ngritur në kërkesën e 49 deputetëve dhe në vendimin e Kuvendit, apo probleme që mund të dalin nga dëshmitarë, nga institucione, të cilat janë të nevojshme për t'u sqaruar nga ky komision.

Për sa i takon planit të sotëm paraprak, i cili është detyrë e kryetarit për t'ia paraqitur këtij komisioni, ai bazohet në njoftimin e Presidentit të Republikës në lidhje me objektin e hetimit, pikërisht për ngritjen e këtij komisioni hetimor, si dhe të drejtën që ka Presidenti për t'u shprehur në këtë komision. Nëse Presidenti do ta vlerësojë që të vijë, është e drejta e tij, por, nga ana tjetër, ky komision, përtej të drejtës së Presidentit, ka dhe të drejtën e tij për ta thirrur Presidentin në një dëgjese, nëse ne e vlerësojmë si të domosdoshme praninë e Presidentit.

Pikë tjetër e planit paraprak është marrja e të dhënave zyrtare dhe jo zyrtare, që njihen publikisht nga institucionet, lidhur me objektin e hetimit të këtij komisioni. Këtu do të mbahet parasysh, në planin përfundimtar, kërkesa juaj që të kemi, përveç dokumentacionit shkresor, edhe pamje filmike, të dhëna nga AMA për publikime në portale, në rrjetet sociale apo në medie të caktuara.

Pikë e katërt e planit paraprak është përgatitja dhe miratimi i planit përfundimtar të hetimit.

Pikë të pestë do të kemi caktimin e ekspertëve vendas apo të huaj, nëse do ta gjuajmë, për marrjen e ekspertizës që kërkon njohuri të posaçme sipas objektit të hetimit. Unë besoj se do të jetë patjetër e domosdoshme që të kemi konsulencën e të paktën një ose dy ekspertëve konstitucionalistë, të cilët do të na ndihmojnë me çështjet e doktrinës apo jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, të gjykatave të tjera kushtetuese të vendeve demokratike apo të Gjykatës Europiane.

Pikë të gjashtë do të kemi një seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës së Shqipërisë.

Pikë e shtatë është verifikimi, shqyrtimi dhe analiza ligjore e provave, e rrethanave, e fakteve dhe e atyre që do të dalin nga seanca dëgjimore apo nga tërësia e hetimit të kryer.

Pikë e tetë do të jetë përgatitja dhe miratimi i raportit përfundimtar që ky komision do t'i paraqesë Kuvendit në seancë. Pastaj do të jetë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbi

bazën e raportit që ky komision hetimor do të paraqesë, që do të vendosë me dy të tretat nëse ka shkaqe të parashikuara nga Kushtetuta për shkelje të rënda të Kushtetutës për t'ia paraqitur më pas Gjykatës Kushtetuese, por, pa e paragjykuar fare këtë proces, ne të fokusohemi në punën e këtij komisioni.

Për sa i përket pretendimit tuaj për buxhetin, zoti Braho, ju bëj me dije se në vendimin e komisionit është ngarkuar administrata e Kuvendit, sekretari i Përgjithshëm për krijimin e të gjitha kushteve të punës së këtij komisioni që patjetër përfshin edhe çështjet financiare, të cilat duhet të jenë të mbuluara të gjitha. Nuk kemi asnjë pengesë për marrjen e çdo lloji ekspertize, për thirrjen e çdo dëshmitari, për marrjen e çdo prove që ne do të gjykojmë.

Koha e punës, afati i këtij komisioni është maksimal 3-javor, prandaj do të kërkoja edhe mirëkuptimin tuaj. Ju falënderoj, së pari, për praninë tuaj në këtë ditë të shtunë! Por fillimi i veprimtarisë kushtëzohej nga ligji brenda 3 ditëve, brenda 3 ditëve pune, prandaj filluam sot dhe, ndoshta, do të ketë edhe ditë të tjera pushimi zyrtar që nuk e pengojnë Kuvendin për të ushtruar veprimtarinë e tij, ku ne do të mbledhemi, në mënyrë që ta përmbyllim detyrën tonë me sukses në afatin e caktuar nga Kuvendi. Ka ndonjë çështje tjetër? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të doja, edhe në kuadër të transparencës që në fillim të çdo mbledhjeje të komisionit, pavarësisht se mbledhjet e komisionit transmetohen *live*, të ketë një njoftim për gazetarët, një njoftim shtypi, i cili të japë një informacion se për çfarë është diskutuar dhe mendimet. Kjo do të ishte e dobishme, me qëllim që asnjëri nga ne të mos flasë. Unë pajtohem me propozimin që bëri kolegu Braho. Sugjerimi im është që nga ky moment ne nuk kemi asnjë të drejtë të dalim në medie, të prononcohemi, të japim mendime dhe të shprehemi, për aq kohë sa jemi anëtarë të këtij komisioni, por media dhe publiku i gjerë kanë nevojë të kenë një njoftim për shtyp, pasi njoftimi që ne nxjerrim në faqen e Kuvendit: “U mbledh komisioni me përbërje dhe diskutoi për këtë gjë”, nuk është, do të thosha, i plotë dhe i përshtatshëm për kërkesat dhe kërshërinë që ka media.

I uroj koleges Bushka suksese në detyrën që iu ngarkua! Lidhur me planin paraprak dhe faktin që kemi vetëm 3 javë kohë do të ishte mirë që të kishim një planifikim kalendari. Ky kalendar do të ishte i domosdoshëm. Unë e kuptoj që do të ketë dinamikë, sepse 3 javë janë, por, nëse ne do të bënim një kalendar, sikurse e kemi bërë edhe për komisionet hetimore parlamentare, kjo do ta orientonte shumë mirë punën e sekretariatit të komisionit, të anëtarëve të komisionit, por do të krijonte mundësi qoftë për Presidentin e Republikës apo për të gjithë dëshmitarët që do të thirren, të planifikojnë kohën dhe të mos të vihemi para të papriturave për

të thënë: “Kam axhendë, nuk kam mundësi” dhe të nxjerrin arsye të tjera që mund të jenë edhe objektive, por mund të jenë dhe subjektive.

Lidhur me rregulloren, ne kemi model të rregulloreve të Kuvendit, ndoshta, të kemi një draft të rregullores, ta diskutojmë në këtë fundjavë me njëri-tjetrin dhe ta miratojmë në mbledhjen më të parë të mundshme pas mbledhjes së sotme.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zonja Hysi!

Patjetër që unë thashë se orët janë të çmuara për këtë komision. Do të detyrohem të punojmë edhe gjatë fundjavës, kështu që sekretaria do të vërë në dispozicion një projektregullore, të cilën secili nga ju mund ta shqyrtojë, mund ta pasurojë, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të fillimjavës që vjen, të miratojmë rregulloren dhe, patjetër do të miratojmë, sikurse është përcaktuar në përmbledhjet vijuese, edhe kalendari. Por sot është mbledhje konstituive dhe sipas ligjit janë të përcaktuara pikat e rendit të ditës dhe hapat që ndjek ky komision.

Kërkoj mirëkuptimin tuaj që ne të jemi striktë në çdo hap që hedhim, ashtu siç e përcakton Rregullorja e Kuvendit dhe ligji i posaçëm për komisionet hetimore.

Ky komision bazohet, përveç Kushtetutës, në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si bazë ligjore, në ligjin “Për organizmin dhe funksionimin e komisioneve hetimore” dhe në Rregulloren e Kuvendit. Këto janë busullat ligjore që ne do të ndjekim për të mos gabuar dhe për të kryer një mision specifik dhe të veçantë dhe delikat, sikurse e shpreha, të këtij parlamenti.

Më duhet ta hedh në votim planin paraprak të hetimit, nëse nuk ka ndonjë koment.

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Po i referohem vetëm diskutimit tuaj të fundit, në lidhje me bazën ligjore të komisionit. Do të kërkoja që në vijim të propozimit të zotit Braho, të shtohet edhe e gjithë gama e opinionëve të Komisionit të Venecias në lidhje me këtë çështje, pra të jetë pjesë e planit paraprak të hetimit. Sipas procedurës, ne sot njoftohemi për një plan paraprak hetimi, biem dakord për të dhe pasi mbaron faza e mbledhjes së dokumentacionit apo administrimit të informacionit nga autoritetet përkatëse, më pas ne do të kemi një moment të dytë ku miratojmë planin përfundimtar të hetimit. Por, duke qenë se bëhet fjalë për bazën ligjore, që është pjesë e planit të hetimit, duhet thënë që sot që, pa diskutim, opinionet e Komisionit të Venecias duhet të jenë pjesë e planit paraprak të hetimit.

Alket Hyseni – Duhet të përdorim një term të gjerë, çdo akt të Gjykatës Kushtetuese dhe të Komisionit të Venecias dhe të doktrinës dhe jurisprudencës, që janë të nevojshëm dhe i shërbejnë komisionit.

Klotilda Bushka – Ju vë në dijeni se vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ne janë të detyrueshme, kështu që te pjesa e planit të hetimit jo të gjitha ligjet do të citohen. Ne flasim për ato ligje që lidhen me objektin e punës së këtij komisioni dhe opinionet e Komisionit të Venecias janë pa diskutim të posaçme për t'u marrë në shqyrtim, ndërkohë që ka shumë ligje në Republikën e Shqipërisë që do të na duhet t'i përdorim gjatë punës së komisionit, por kjo s'është thotë se s'janë të plani paraprak i hetimit. Ne po flasim për atë që i shërben thelbit që objektit të gjykimit.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Urdhëroni, zoti Murrizi!

Myslim Murrizi – Faleminderit, kryetar!

Te hapat proceduralë që do të ndiqen nga komisioni, te pika 3, shoh marrjen e të dhënave zyrtare dhe jozyrtare që njihen publikisht lidhen me objektin e hetimit. Do të doja që në emër të komisionit, nëse komisioni është dakord, t'i kërkoja zyrtarisht informacion agjencive ligjzbatuese, Shërbimit Informativ Kombëtar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Antiterrorit, për t'u njoftuar ne si komision, se çfarë informacionesh kanë pasur këto agjenci ligjzbatuese gjatë 30 ditëve fushatë, çfarë ndikimi dhe efekti kanë pasur në elementët kontigjentë të shoqërisë shqiptare deklaratat publike të Presidentit të Republikës për nxitje dhune. Pra, duhet të na vënë në dispozicion mënyrën se si e kanë parë ata situatën *underground*, nga thirrjet publike apo veprimtaria publike e Presidentit të Republikës, e cila nga 49 deputetë të maxhorancës, kërkues për ngritjen e këtij komisioni hetimor, është gjykuar se ka qenë në cenim të të drejtave të tij kushtetuese, prishje e unitetit të kombit, shkelje e Kodit Zgjedhor.

Siç thotë edhe Kodi i Procedurës Penale, mendoj se për pjesën e materialeve që do të na vijnë nga agjencitë ligjzbatuese, që janë konfidente, nuk ka pse bëhen publike, meqenëse ky është komision hetimor, ndërsa deklaratat publike të çdo anëtari të komisionit, të jenë ashtu siç ai e gjykon, por pa cenuar thelbin e hetimit dhe pa shkelur Kodin e Procedurës. Nuk besoj se ka ndonjë gjë hermetike, sepse duke lakmuar fort që të mos flasim e të mos flasim, do të na paragjykojnë, a thua se kushedi çfarë po bëjmë, sikur po bëjmë puç apo po gërmojmë nën dhe për të gjetur të pagjeturën. Këto janë publike, ato fakte që kërkoi zoti Braho, të merren të gjitha deklaratat publike të Presidentit të Republikës. Përpos kësaj, do të kërkoja nga agjencitë ligjzbatuese, se ndoshta kanë informacion konfidencial, me aq sa unë kam dijeni, se ndoshta

ka takime me elementë të botës së krimit, takime për qëllime elektorale, takime me individë që mund të nxisin dhunë, ndonjë farë tentative për të organizuar me datën 25 apo pas datës 25, në varësi të rezultatit, revolta etj. Në lidhje me këto nuk jemi kompetentë asnjëri nga ne, ndaj duhet të na i vënë në dispozicion agjencitë ligjzbatuese të këtij vendi, nëpërmjet kërkesës zyrtare që duhet të bëjë komisioni.

Kaq kisha. Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Murrizi!

Zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, në vijim të diskutimit që bëri zoti Braho, por edhe zonja Bushka, lidhur me Komisionin e Venecias dhe opinionet e tij, patjetër që duhet të jenë pjesë e legjislacionit që do të përdorim, por unë do të doja të sillja në vëmendje faktin se ne duhet të përdorim edhe diskutimet që janë bërë nga hartuesit e Kushtetutës dhe çfarë kanë pasur ata parasysh kur kanë thënë: “shkelje të rëndë të Kushtetutës”. Pra, mendoj se duhet të vihen në dispozicion nga arshiva e Kuvendit, për të parë se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësve apo i atyre që kanë hartuar Kushtetutën në ato momente.

Nga ana tjetër, do të sillja në vëmendje tuaj se duhet të jemi shumë të kujdesshëm, që t’i bëjmë njoftimin Presidentit lidhur me qëllimin se përse është ngritur ky komision, objektin e tij. Do t’ju kërkoja të ishit sa më të kujdesshëm, duke bërë një njoftim të plotë, të arsyetuar, pa munguar asnjë e dhënë e asnjë dokumentacion, që edhe ai të vihet në dijeni, që t’i japim të drejtën për t’u mbrojtur e për t’u paraqitur para komisionit ashtu siç ia garanton Kushtetuta dhe ligjet e këtij vendi.

Pra, do të duhet të jemi të kujdesshëm te kjo pjesë, që atij të mos i mungojë asnjë informacion lidhur me atë çfarë ne jemi duke hetuar dhe me qëllimin që ka ky komision.

Lidhur me sa tha zoti Murrizi, do të isha shumë dakord, por vetëm do të kemi kujdes, nëse kemi të gjithë certifikata sigurie dhe a mundemi ne të gjithë të vihemi në dijeni të këtyre informacioneve të klasifikuara. Kjo është pjesë që ju ngelet juve. Unë po, por nuk jemi të gjithë njësoj. Se ne, meqenëse jemi pjesë e Komisionit të Sigurisë, unë dhe ti kemi, por për të tjetër nuk e di. Është pjesë e sekretariati dhe e juaja, që ta keni në vëmendje këtë pjesë.

Faleminderit!

Alket Hysni - Zonja Xhina, të falënderoj.

Mos u shqetësoni.

E para, bazuar në ligjin “Për funksionimin e komisioneve hetimore”, por edhe në ligjin “Për sekretin shtetëror” duhet të jetë i pajisur çdo deputet, që të ruajë sekretin shtetëror së pari

dhe në varësi të shkallës të klasifikimit të atij dokumenti duhet të kemi edhe certifikatat përkatëse. Unë, në emrin tuaj, i kam kërkuar administratës, të fillojë menjëherë veprimet për verifikimin se kush nga anëtarët e komisionit nuk është i pajisur me certifikatë dhe të aplikohet për pajisjen me certifikatën e sigurisë, kështu që secili do të komunikohet nga administrata. Mos u shqetësoni. Ata që s'janë të pajisur, se mund të ketë ndonjë deputet që nuk ka certifikatë sigurie, dy janë, se pjesa tjetër e ka, kështu që besoj se është një çështje që do të zgjidhet.

Mos kini merak për këtë aspekt.

Së dyti, kërkoj mirëkuptimin tuaj, sepse nuk do të avancojmë me plane hetimi, përveç faktit të përfshirjes së bazës ligjore që thamë, të planit paraprak, sepse kaq është rendi i ditës. Në mbledhjen tjetër, do të mirëpresim çdo sugjerim tuajin, se çfarë veprimesh hetimore kërkon ju. Duhet të kuptoni që çdo anëtar komisioni, bazuar në ligjin specifik, ka të drejtën të propozojë dhe, pa u hedhur në votim, merret parasysh kërkesa. Këtu kërkoj përsëri mirëkuptimin tuaj, që duhet të jemi të qartë, të saktë në atë çfarë kërkojmë. Të kërkojmë gjërat që kanë lidhje me objektin, gjëra që janë në përputhje me ligjin, në mënyrë që të mos krijojmë debate, por edhe t'i shërbejmë funksionit që ne kemi si anëtarë të këtij komisioni.

Ka ndonjë merak tjetër sa i takon planit paraprak, apo ta hedhim në votim? Atëherë, nuk ka. E hedhim në votim, patjetër me sugjerimet që u thanë nga kolegja Bushka dhe nga kolegët e tjerë.

Kush është dakord me planin paraprak të hetimit? Pra, të gjithë jemi dakord. Me 9 vota pro, miratohet plani paraprak i hetimit.

Atëherë, duke gjykuar se i kemi përmbushur të gjitha pikat e rendit të ditës dhe të gjitha kërkesat që ligji përcakton për mbledhjen e parë konstituive, duke e konsideruar të konstituar këtë komision me vendimet e rëndësishme që mori sot, le t'i urojmë këtij komisioni punë të mbarë, le t'i urojmë parlamentarizmit shqiptar suksese dhe vijimësi në punën e tij, le t'i urojmë Republikës tonë të jetë e fortë, dhe e fortë bëhet kur institucionet punojnë, punojnë në zbatim të Kushtetutës, në zbatimin strikt të kushtëzimeve të Kushtetutës dhe ligjeve të këtij vendi dhe asnjë fakt dhe element nuk duhet të paragjykohe.

Edhe një herë, kërkoj mirëkuptimin tuaj për shmangien e deklaratave politike apo deklaratave të nxituara rreth veprimtarisë të këtij komisioni.

Mbledhja tjetër do t'ju njoftohet nga sekretaria.

Ju uroj punë të mbarë dhe fundjavë të mbarë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA